



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0704

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga panelisti individual, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Ejona" SH.P.K, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit 214-24-1625-1-1-1, me 30/12/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa operatorit ekonomik, OE; "EJONA " SH.P.K nr. 2024/0704, e datës 02/08/2024, kundër " Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit", prokurimi me titull "Furnizimi, montimi dhe lëshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare" me numer të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1" AK- Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbetet në fuqi “Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit” datës, 16.07.2024, me numer të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1", AK- Ministria e Punëve të Brendshme, i bazuar në nenin 26, paragrafi 2 dhe nenin 62 paragrafi 1, nënparag.1.1, të LPP.
- 3.Urdhërohet, autoriteti kontraktues konform nenit 30, në emër të dëmit për kompensimin e shpenzimeve procedurale, OE ankues, "EJONA " SH.P.K, të paguajë vlerën e përcaktuar sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.
4. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE "EJONA " SH.P.K, sipas nenit 31 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.03.2024, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit 214-24-1625-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 259,240.00 €.

Me 27.05.2024, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Ejona" SH.P.K ndërkaq nënshkrimi i kontratës është planifikuar të bëhet me datën 29.05.2024.

Me datën 16.07.2024 autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për anulim të procedurës së prokurimit “Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit 214-24-1625-1-1-1 ku si arsye të anulimit të procedurës është, ka theksuar se nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik

Me 02.08.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Ejona" SH.P.K me nr. 2024/0704 lidhur me aktivitetin “Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit 214-24-1625-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim të operatorit "Ejona" SHPK

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimi të Kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, të tenderuesit “Ejona”. Pas analizës së pretendimeve të cekura në Kërkesën për rishqyrtim, AK ka ardhur në konstatimin se pretendimi i tenderuesit Ejona është i pabazuar, sepse AK e ka anuluar procedurën e prokurimit pas hapjes së

tenderëve, mbështetur në një shkelje e LPP-së, një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit; Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në zbatim të ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/1-092 Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim:

Konkluzion:

I. Refuzohet, Kërkesa për rishqyrtim e tenderuesit “Ejona”, kundër Njoftimit për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit të këtij aktiviteti të prokurimit, publikuar me 17.07.2024, kërkesa për shqyrtim i refuzohet e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi për Anulimin e aktivitetit të prokurimit i publikuar me 17.07.2024 nga ana e AK.

Pretendimet ankimore “Ejona” SH.P.K në ankesën Nr. 704/24

AK ka shkelur nenet e lartepërmendura, duke shpallur jashteligjshëm "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit Kronologjia e ngjarjeve të këtij aktiviteti është si më poshtë: 1) Më 17.05.2024 Jemi shpallur fitues nga AK; 2) Më 27.05.2024 është shpallur "Njoftimi për dhenie të kontrates" me datën e planifikuar për nënshkrim me 29.05.2024; 3) Më 05.06.2024 është ngarkuar në sistem Draft Kontrata dhe e kemi aprovuar të dyja palët; 4) Gjate kësaj periudhe deri në njoftimin për anulim kemi pritur ftesën nga AK për nënshkrim të kontrates, ku përmes telefonatave në numrat zyrtar na është komentuar se janë në pritje të përgaditjes së kontrates dhe se shumë shpejtë do na therrasin për nënshkrim; 5) Më 17.07.2024 AK ngarkon në sistem pa asnjë paralajmërim "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" me arsyetimin: "Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik".

Pra, në mënyrë të jashteligjshme pa u përmbushur asnjë kusht për anulim, AK shpallë Njoftimin për Anulim të Aktivitetit gjatë periudhës sa kemi qenë në pritje për nënshkrim të kontrates, ku kompania jone ka qenë në përgaditje për implementimin e kontrates. Asnjë kusht i vetëm nuk është plotësuar për Anulim të procedurës, ndërsa janë plotësuar të gjitha kushtet për nënshkrim të kontrates. Ia rikujtojmë AK se nuk mund të thirret në paragrafin: 1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Pra, pretendimi i AK për anulim nuk është shkelje e ligjit që nuk mund të rregullohet!. Ajo mund të rregullohet me nënshkrim të kontrates nga zyrtarët përkatës!. Për këtë projekt, kompania jone vecse ka pasur shumë shpenzime ku kemi dërguar pjestare të stafit në trajnime tek fabrika dhe kemi futur në porosi ashensorët për këtë projekt duke e ditur rëndësinë e objekteve dhe për të shmangur vonesat dhe parregullsitë. Për këtë kemi edhe prova që do të ofrojmë gjatë procedurave gjyqësore për kompensim të demit, në rast se nuk kemi përkrahjen e OSHP në këtë lende. E perserisim se: Në këtë procedurë nuk është plotësuar asnjë kusht për anulimin e aktivitetit, si dhe janë plotësuar të gjitha kushtet për nënshkrim të kontrates. Ky është vendimi me qesharak që kemi parë ndonjëherë i lëshuar nga një Autoritet Kontraktues. Përfundim: Kërkojmë nga OSHP që të anulojë Njoftimin e jashteligjshëm për Anulimin e Aktivitetit dhe të obligojë AK që të vazhdojë me nënshkrimin e Kontrates sipas LPP dhe sipas Njoftimit për Dhenie të Kontrates të datës 27.05.2024.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0704/24, ndërsa me datë 13/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0704 me rekomandimet si në vijim: ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe AK-së të trajtoj lëndën në pajtim me paragrafit 2 dhe paragrafit 4 të nenit 26 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet e OE "Ejona" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0704 ka vlerësuar si në vijim:

Me datën: 02.08.2024, OE "EJONA" SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0704, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi, montimi dhe leshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare" me nr. të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

- Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, ka zhvilluar Aktivitetin e Prokurimit me titull: "Furnizimi, montimi dhe leshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare", me nr. të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1".
- Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: 07.03.2024.
- Hapja e ofertave është bërë me datë: 18.04.2024 ora: 14:00:00.
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së është bërë me datë: 17.05.2024.
- Njoftim për dhënie të kontratës është bërë me datë: 27.05.2024.
- Njoftimi për anulimin e aktivitetit te prokurimit është bërë me datë: 16.07.2024.
- Me datë: 18.07.2024, operatori ekonomik: "Ejona", ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK - Ministria e Punëve të Brendshme.
- Ministria e Punëve të Brendshme, me datë: 23.07.2024, mori Vendim për Refuzimin e kërkesës të ri-shqyrtimit të OE "Ejona".
- Operatori ekonomik pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga AK, me datë: 02.08.2024, ka parashtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik.
- Operatori ekonomik: OE "Ejona" në Ankesën e parashtruar pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik, i ka paraqitur pretendimet e tij.
- Eksperti Shqyrtues pas pranimit të lëndës për ekspertizë, i ka analizuar të gjitha pretendimet e OE Ankues, dhe i ka trajtuar me kujdes duke i'u referuar legjislacionit.

Përgjigje në pretendimet ankimore

I pakënaqur me vendimin e AK Operatori Ekonomik ankues "Ejona" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 18.07.2024, kërkesë kjo e cila është refuzuar si e bazuar. OE pretendon se AK me Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit, ka bërë shkelje të nenit 43 dhe nenit 62 të LPP-së si dhe nenit 26 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

AK - Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 17.05.02024 kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, në të cilin ishte shpërblyer me kontratë OE, "Ejona" SH.P.K në vlerë prej 179,7444.44 €. Me datë 27.05.2024, AK kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës dhe kishte planifikuar nënshkrimin e kontratës me datë 29.05.2024. Në vijim, me datë 05.06.2024, AK ngarkon në platformën e-prokurimi Draft kontratën e cila aprovohet nga të dyja palët. Gjatë

kohës sa ka qenë në pritje të nënshkrimit të kontratës, AK - Ministria e Punëve të Brendshme me datë 17.07.2024 ngarkon në platformën e-prokurimi, pa asnjë paralajmërim "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" me arsyetimin: "Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik". OE ankues më këtë veprim pretendon se AK ka anuluar procedurën e prokurimit në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa u përmbushë asnjë kusht për anulim.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të tërë dokumentacionit si dhe shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë ka vërejtur se mungojnë detaje që lidhen me njoftimin mbi anulimin e procedurës së prokurimit. Arsye e anulimit të procedurës në Njoftimin mbi Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit nga ana e AK-së është thënë të jetë se nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili thotë si në vazhdim:

2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nga kjo rregull përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.

Duke pas parasysh se AK nuk ka dhënë informacione të mjaftueshme mbi anulimin e procedurës së prokurimit, eksperti shqyrtues ka dërguar kërkesë për informacion shtesë pranë AK-së përkatësisht Divizionit të Prokurimit, prej të cilëve është kërkuar të sqarohet se cila prej pikave të paragrafit 4 të nenit 26 të LPP-së nuk janë plotësuar që kontrata të nënshkruhet apo ndonjë arsye tjetër, ndonjë dokument, që lidhet me njoftimin mbi anulimin e procedurës së prokurimit. Në përgjigjen e tij ZPP i AK-së ka pohuar se, ka pranuar një e-mail me të cilin është njoftuar për mosnënshkrim të kontratës nga ana e ZKA-së dhe Ministrit. Pas përgjigjeve të pranura nga ZPP i AK, Eksperti shqyrtues sqaron se përfundimin (anulimin) e një Aktiviteti të Prokurimit e parasheh neni 62 i LPP-ës dhe neni 43 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Bazuar në dispozitat e neneve të lartë përmendura përfundimi (anulimi) i një Aktiviteti të Prokurimit mund të ndodh para dhe pas hapjes së Tenderëve për njërën nga arsyet e përmendura në nenet e më sipërme dhe në asnjë mënyrë në fazën në të cilën gjendeni ju si ministri e aq më pak për arsyet e dhëna me e-mail (Nuk është kërkuar e as prezantuar Autorizimi nga prodhuesi; Si dëshmi e garancisë e kërkuar 12 muaj në dosje të tenderit) është prezantuar deklarata e OE; dhe Nuk është kërkuar e as prezantuar se paku katalogu i ashensorëve;) kur dihet që legjislacioni i prokurimit Publik kërkon që kërkesat, kriteret e vendosura në DT të jenë sa ma minimale, të mos ulin konkurrencën, të mos jenë diskriminuese dhe/ose favorizuese dhe kur thuhet qartë në paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së se: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Ndërsa sa i përket nënshkrimit të Kontratave të parapara në nenin 26 të LPP-së. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë kontratat mund të mos bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse nuk janë plotësuar kushtet në vijim:

1. Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;

2. Personat kanë konfirmuar edhe një here se informatat që gjinden në “Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” janë ende të sakta;

3. Personat nuk kanë pranuar asnjë komunikatë nga OSHP ose gjykata në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.

Duke marrë parasysh paragrafët e lartë cekura arsyetimi i ZKA-së dhe Ministrit nuk ka bazë ligjore që të anulohet procedurën.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet si parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesën e Operatorit Ekonomik ankues "EJONA ", Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr; "214-24-1625-1-1-", të Autoritetit Kontraktues, të datës 16.07.2024, dhe Vendimin e dt.23.07.2024 të Autoriteti Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar nga OE "EJONA kundër anulimit të procedurës së prokurimit nga AK.

Paneli Shqyrtues lidhur me Raportin e ekspertit të datës, 13.08.2024, vëren se, neni 26 paragrafi 1 dhe 2- Nënshkrimi i kontratave publike i LPP, neni 62 paragrafi 1 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i LPP-së dhe neni 43.5.i, të Rregullores për Prokurimin Publik nr.01/2022, nuk janë interpretuar mbi bazën e provës materiale të AK, Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. ; "214-24-1625-1-1-1", dhe është nxjerr rekomandim i pabazuar me ligjin e LPP-se. Andaj Paneli Shqyrtues përfundimisht nuk mund ta marr si një fakt të mirëqene dhe nuk ja falë besimin e provës në këtë çështje administrative.

Në nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, e obligon AK që, citat: "Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli Shqyrtues lidhur me Njoftimin e për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, datës, 16.07.2024 aktivitetit të prokurimit nr. "214-24-1625-1-1-1, vëren se AK në faqen tre(3) të Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, në nenin IV.3 Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, ka shënuar se “ Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”.

Po ashtu vërehet se AK në faqen tre (3) të Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, në nenin V.2 Informacionet shtesë, ka shënuar se “ Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26, të Ligjit të Prokurimit Publik .

Paneli Shqyrtues vlerëson se çështja e anulimit të aktivitetit të prokurimit publike, nga ana e Autoriteteve kontraktuese është e rregulluar me legjislacion primar dhe sekondar. Ligji për Prokurim Publik , neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike, paragrafi 1 përcakton” Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual....”

Paragrafi 2 i ligjit përcakton” Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme”.

Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.1 i LPP, përcakton” 1.Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

PO ashtu me legjislacionin sekondar, Rregullorja për Prokurimin Publik, nr.001/2022, neni 43.5.i, përcakton” Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;”

Paneli shqyrtues vrenë se Autoriteti Kontraktues Njoftimin, për anulimin e aktivitetit të prokurimit e ka arsyetuar, duke e cituar dispozitën ligjore të LPP,nenin 62 paragrafi 1 dhe nenparagafi 1.1 “ Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit,e po ashtu ka dhënë informacione shtese për arsyen e anulimit të aktiviteti të prokurimit si “ Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26, të Ligjit të Prokurimit Publik Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik ”.

Paneli Shqyrtues përfundimisht konstaton se Autoriteti Kontraktues Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit e ka bazuar në përputhje me dispozitat ligjore të lartshënuara, nenin 26 paragrafi 1 dhe 2- Nënshkrimi i kontratave publike i LPP, nenin 62 paragrafi 1 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i LPP-së dhe nenin 43.5.i, të Rregullores për Prokurimin Publik nr.01/2022, dispozita të cilat përcaktojnë rregullat e anulimit të aktivitetit të prokurimit nga Autoritet Kontraktuese.

Andaj Paneli Shqyrtues përfundimisht lidhur me ankesën e Operatorit ekonomik "EJONA ", të parashtruar kundër “Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit” datës 16.7.2024 prokurimi me titull "Furnizimi, montimi dhe leshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare” me numer të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1" dhe Vendimit të datës 23.07.2024, për refuzimin e Kërkesa për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues-Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, ka vendosur që ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe mbet në fuqi ,Njoftimi per Anulim te Aktiviteit te Prokurimit, i marr nga Ministria e Puneve te Brendshme, i bazuar në nenin 26, paragrafi 2 dhe nenin 62 paragrafi 1, nënparag,1.1, të LPP.

Andaj, paneli shqyrtues lidhur me këtë çështje nuk ka autorizime ligjore në këtë fazë dhe për këtë nuk mund ta obligoj asnjë autoritet kontraktues që të bëjë nënshkrimin e kontratës. Megjithatë, ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit aktivitetit të prokurimit, mund ti drejtohet Gjykatës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.

Paneli shqyrtues konstaton se këtë aktivitet të prokurimit e ka iniciuar autoriteti kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme, të cilin aktivitet prokurimi edhe e ka anuluar vete ky autoritet dhe se OE ankues "EJONA", nuk i ka kontribuar në asnjë mënyrë anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit andaj Paneli shqyrtues kërkon nga autoriteti kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme, konform nenit 30, në emër të dëmit, për kompensimin e shpenzimeve procedurale, OE ankues, "EJONA " SH.P.K, të paguajë vlerën e përcaktuar sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjesërishtëm të ankesës të OE ""EJONA ", Sh.P.K, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e

përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe vendosi sipas dispozitave ligjore të lartcekura, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: